



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202201264/5

Tiranë ___/___/2022

Lënda : *Rekomandim për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me shtetasit e shoqëruar dhe për marrjen e kallëzimeve/ankimeve të tyre.*

KOMISARIATIT TË POLICISË NR. 2
Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Tiranë

Me shkresën nr. K2/M15-2 prot., datë 07.11.2022 ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetasi M.K.. Ankuesi shkruan se është student në vitin e katërt në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Në datën 08.09.2022, rreth orës 11:00, ai ka pasur një konflikt verbal me z. K.M., pedagog i lëndës së të Drejtës Penale të Posaçme në këtë fakultet. Pas konfliktit ankuesi ka njoftuar në telefon shërbimet e Policisë së Shtetit. Sipas tij, në Fakultetin e Drejtësisë kanë mbërritur punonjësit e policisë, të cilët së bashku me pedagogun K.M. dhe Zv/Dekanin E.M. janë futur në zyrën e tyre, ndërsa ai ka qëndruar jashtë në korridor. Pasi punonjësit e policisë dolën nga zyra i kanë komunikuar atij se së bashku me pedagogun do të shoqëroheshin në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë për të kryer veprime procedurale në lidhje me këtë konflikt.

Në momentin që mbërritën në komisarjat, atë e kanë futur në dhomën e shoqërimit ku ka qëndruar rreth 9 orë. Ndërkohë që pedagogut K.M. i është bërë privilegj nga oficerët e

policisë gjyqësore duke i marrë të parit kallëzimin ndaj tij, ndonëse viktimë e konfliktit në këtë rast ishte ai. Sipas ankuesit M.K., ky veprim përbën diskriminim dhe një paragjykim ndaj të vërtetës.

Pas rreth 9 orësh qëndrimi në gjendje shoqërimi, ai është dërguar kundër vullnetit të tij me autoambulancë dhe i shoqëruar me forca policie në Spitalin Psikiatrik për ekzaminim mjekësor. Pasi nga ekzaminimi psikiatrik rezultoi se gëzonte shëndet mendor të plotë ai është risjellë përsëri në komisariat edhe për rreth 30 minuta e më pas është lënë i lirë.

Ankuesi shkruan se nuk është kundër veprimit të shoqërimit në komisariat, por ka pretendime për trajtimin e tij të diferencuar, si mbajtjen për një kohë të gjatë në gjendje shoqërimi dhe dërgimin në Spitalin Psikiatrik jashtë vullnetit të tij. Po ashtu, ai pretendon se dërgimi në spital është i kundërligjshëm sepse kjo lloj vendimmarrjeje nuk është kompetencë e policisë por e prokurorisë dhe e gjykatës gjatë procesit penal. Sipas tij, ky veprim i kryer nga policia i ka cënuar rëndë dinjitetin.

Gjithashtu ankuesi pretendon se oficerët e policisë gjyqësore Skerdi Kasimati dhe Florian Çeka të cilët punuan me atë, nuk kanë përpiluar e dhënë atij kopjen e “Procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarin”, sikurse parashikohet në nenin 109/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në Kreun e VII-të, pika 1, gërma “f” dhe Kreun e VIII-të, pikat a.3.3 dhe a.3.4 të Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Sqarojmë se objekt i këtij rekomandimi janë disa aspekte procedurale të shoqërimit, por jo zgjidhja e mosmarrëveshjes ndërmjet studentit M.K. me pedagogun K.M..

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, ju kërkuam që të na dërgoni një informacion lidhur me sa më poshtë vijon:

1. Cilat janë shkaqet dhe baza ligjore e mbajtjes për më shumë se 9 orë e 30 minuta në gjendje shoqërimi të ankuesit M.K.?
2. Çfarë veprimesh procedurale janë kryer nga organi juaj lidhur me këtë ngjarje?
3. Cilat janë shkaqet dhe baza ligjore e dërgimit të ankuesit në Spitalin Psikiatrik?
4. Cili punonjës policie ka kryer veprime me të shoqëruarin M.K.?
5. Cili është qëndrimi juaj në lidhje me pretendimin e ankuesit se nga oficerët e policisë gjyqësore që kryen veprime me të nuk është përpiluar e dhënë atij kopje e “Procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarin”?
6. Nëse ky pretendim është i vërtetë, cilat janë shkaqet e këtij qëndrimi?

Bashkë me informacionin ju kërkuam të na dërgoni edhe fotokopje të fletëve të regjistrit të shtetasve të shoqëruar në polici në datë 08.09.2022 në të cilat janë pasqyruar gjeneralitetet e ankuesit, të formularit të raportit të shoqërimit të tij, të procesverbalit mbi veprimet e kryera me personin e shoqëruar, si dhe të dokumenteve të administruara nga ana juaj lidhur me këtë rast.

Ju me shkresën nr. 5710/1 prot., datë 18.11.2022, na informuat se në datën 08.09.2022, në mesditë Patrulla e Përgjithshme e Policisë është njoftuar nga salla Operative e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë që të shkonte në ambientet e Fakultetit të Drejtësisë Tiranë në të cilin kishte ndodhur një konflikt. Patrulla ka shkuar menjëherë në Fakultetin e Drejtësisë dhe ka marrë takim me shtetasin M.K. (Sulçe), student i këtij fakulteti dhe shtetasin K.M., pedagog po në këtë fakultet. Patrulla është informuar se pedagogu K.M. gjendej në zyrën e Zv/Dekanit për të adresuar problemet e vazhdueshme që po i sillte studenti M.K.. Zv/Dekani i kishte sugjeruar pedagogut që të qëndronte në zyrën e tij me qëllim që të shmangte kontaktet dhe konfliktin me studentin M.K..

Ndodhur në këtë situatë patrulla vendosi të bënte shoqërimin e të dy palëve në Komisarariat e Policisë nr. 2 Tiranë. Në momentin që këta dy shtetas ishin në korridorin e komisarariatit, shtetasi M.K. ka filluar të flasë me zë të lartë dhe në mënyrë jo etike duke bërë presion ndaj punonjësve të policisë, pedagogut K.M. si dhe lëshuar fjalë po logjikë e të pakuptimta. Në këtë kohë, rreth orës 12:30, është bërë shoqërimi i shtetasit M.K. në dhomën e shoqërimit. Gjatë kohës së qëndrimit në këtë ambient ai është shprehur se: “do t’i bie murit me kokë” dhe “jam zeusi”, si dhe u binte dyerve dhe fliste përçartë. Këto fakte janë të pasqyruara edhe në librin e ngjarjeve në objekt/komisariat (dinamika ditore).

Në lidhje me kohën e mbajtjes në gjendje shoqërimi në ambientet e policisë, na informuat se ajo është e lejueshme deri në 10 orë sipas nenit 109 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Kjo kohë ka qenë e nevojshme për të kryer procedurat penale dhe identifikimin e personit të shoqëruar. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion konkretisht të regjistrit të personave të shoqëruar, koha e shoqërimit ka qenë nga ora 12:30 deri në orën 21:10, që përkon me kohën 8 orë e 40 minuta, duke përfshirë edhe kohën e marrë me autoambulancë për shërbim mjekësor.

Ndërsa lidhur me veprimet procedurale të kryera për këtë rast na informuat se, i janë marrë kallëzimi dhe deklarimi shtetasit K.M., prej të cilit janë marrë e administruar edhe kopje të materialeve të publikuara në rrjetet sociale, pamjet filmike të Fakultetit të Drejtësisë. Gjatë shpjegimeve të bëra pedagogu K.M. ka deklaruar se studenti M.K. (Sulçe) ka probleme mendore (psikologjike). Gjithashtu është pyetur edhe studenti M.K. në lidhje me rrethanat e ngjarjes si dhe i është marrë e administruar një CD me pamjet filmike të dorëzuara prej tij.

Të gjitha materialet procedurale të administruara i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me shkresën nr. 6557/k, datë 13.09.2022. Gjithashtu

këtij organi i janë dërguar edhe materiale shtesë, si praktika disiplinore e mbajtur nga Dekani i Fakultetit të Drejtësisë për studentin M.K. (Sulçe) dhe deklarime shtesë të pedagogut K.M..

Në lidhje me dërgimin e shtetasit M.K. (Sulçe) në ambientet e Spitalit Psikiatrik u informuam se, që në momentet e para të mbërritjes së Patrullës së Përgjithshme në mjediset e Fakultetit të Drejtësisë ka konstatuar se gjendja e tij psikologjike ka qenë mjaft e rënduar. Ai i drejtohej pedagogut dhe punonjësve të policisë me një fjalor të papërshtatshëm, kërcënues dhe të pakuptimtë. Që në këtë moment patrulla ka krijuar dyshime për gjendjen e tij psikologjike. Gjithashtu edhe pedagogu ka informuar se studenti M.K. ka një gjendje psikologjike të paqëndrueshme, sjellje herë agresive dhe jo vetëm me të por edhe me pjesën tjetër të stafit të Fakultetit të Drejtësisë. Sipas pedagogut, ai ngre pretendime absurde, komunikon me personelin akademik në mënyrë të papërshtatshme, me një gjuhë të ashpër shpesh herë me nota shantazhuese e kërcënuese. Këto sjellje ky shtetas i ka manifestuar edhe në ambientet e komisariatit.

Sipas përgjigjes, në rastet kur të shoqëruarit shfaqin probleme të shëndetit, oficeri i informacionit përgjegjës edhe për këtë kategori personash, është i detyruar që të njoftojë stafin mjekësor. Në këtë rast ai ka njoftuar urgjencën në numrin 127. Pas njoftimit autoambulanca me stafin mjekësor është paraqitur në komisariat. Mjeku përkatës pasi u informua nga punonjësit e policisë dhe komunikoi me shtetasin M.K., me mirëkuptimin e këtij të fundit shkuan në spital për kontroll mjekësor. Pas kësaj ai është rikthyer në komisariat për të vijuar e shteruar procedurat përkatëse dhe në përfundim të tyre është lënë i lirë.

Me të shoqëruarin janë kryer veprime nga oficeri i policisë gjyqësore Florian Çeka, Nd/Specialisti i Policimit në Komunitet Edison Visha dhe Patrulla e Përgjithshme e turnit të dytë.

Gjithashtu na informuat se proceverbali për veprimet e kryera me të shoqëruarin është përpiluar nga punonjësi i policisë që punoi me të dhe se i shoqëruari nuk ka paraqitur asnjë lloj pretendimi, fakt të cilin e ka pasqyruar vetë në këtë dokument dhe e ka firmosur atë.

Bashkëlidhur me informacionin ju na dërguat edhe fotokopje të dokumentacionit, si fletëve të regjistrit të personave të shoqëruar në këtë komisariat, të formularit të shoqërimit në polici të shtetasit M.K., të procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarin, deklaramet shtesë të shtetasit K.M., të materialeve të dorëzuara nga shtetasi K.M. dhe të praktikës disiplinore të filluar ndaj studentit M.K. nga Fakulteti i Drejtësisë.

Avokati i Popullit ka bërë hetim të zgjeruar lidhur me këtë rast dhe ndonëse nuk ka konstatuar shkeljet e pretenduara nga ankuesi ndaj punonjësve të policisë si dhe sjellje diskriminuese dhe paragjyquese ndaj tij, ka vënë re disa probleme që duhen adresuar për të përmirësuar punën e strukturave të policisë në të ardhmen.

Pas shqyrtimit të ankesës së bërë nga shtetasi M.K., të përgjigjes dhe dokumentacionit të dërguar nga ana juaj konstatojmë se:

1. Në rrethanat dhe në situatën e krijuar nga konflikti i ndodhur ndërmjet studentit të Fakultetit të Drejtësisë M.K. dhe pedagogut të këtij fakulteti K.M., vlerësojmë se veprimi i kryer nga Patrulla e Përgjithshme duke bërë shoqërimin e tyre në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr. 2 është një veprim i kryer në përputhje me nenet 6/25¹, 109² të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

2. Në përgjigjen e dërguar ju shpreheni se koha e mbajtjes në gjendje shoqërimi në ambientet e policisë të një shtetasi është e lejueshme deri në 10 orë, sipas nenit 109 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Kjo kohë ka qenë e nevojshme për të kryer procedurat penale dhe identifikimin e personit të shoqëruar. Koha e mbajtjes së tij në

¹ Neni 6 “Përkufizime”

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

25. “Shoqërimi” është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.

² Neni 109 “Shoqërimi në polici”

1. Punonjësi i policisë bën shoqërimin e personave në ambientet e Policisë ose institucionin urdhërdhënës në kushtet dhe rastet e mëposhtme:

- a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
- b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose ndonjë detyrimi të përcaktuar me ligj;
- c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale;
- ç) për të parandaluar kryerjen e një veprë penale;
- d) kur është larguar pas kryerjes së një veprë penale;
- dh) për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, sipas kushteve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale;
- e) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose shoqërimin e tij në organin kompetent;
- ë) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paafte mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
- f) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose ekstradimit.

2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.

3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimin. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

4. Efektivi i policisë njofton menjëherë qendrën operative për gjenealitetet e personit të shoqëruar, kur ato njihen, orën e saktë të shoqërimin dhe shkaqet e tij. Të dhënat e komunikuar nga efektivi i policisë hidhen menjëherë në sistemin elektronik të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave. Mosrespektimi nga efektivi i policisë i detyrimeve të përcaktuara në këtë pikë përbën shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

5. Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.

6. Punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftojë menjëherë eprorin e vet ose institucionin e interesuar për sqarimin e çështjes. Të dhënat e veprimeve të kryera me personat e shoqëruar dokumentohen gjithashtu në regjistrat/librat që mbahen për këtë qëllim në ambientet e policisë ku është bërë shoqërimi i personit.

7. Për rastet e shoqërimin për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, për dëbimin ose ekstradimin, procedurat dhe afatet e mbajtjes përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

8. Rregullat teknike të shoqërimin, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar në ambientet e policisë përcaktohen nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

gjendje shoqërimi duke përfshirë edhe kohën e dërgimit në spital për ekzaminim ka qenë 8 orë e 40 minuta.

Nga ky perifraksim kuptojmë se nuk është kuptuar drejtë përmbajtja e pikës 2 të nenit 109 të ligjit “Për Polinë e Shtetit” ku parashikohet se: “2. *Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë...*”. Nga analizimi dhe interpretimi i drejtë i përmbajtjes së kësaj dispozite kuptojmë që koha e mbajtjes në gjendje shoqërimi të një personi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes dhe jo deri në 10 orë. Kjo do të thotë se, nëse çështja për të cilën ai është shoqëruar sqarohet shpejt, i shoqëruari duhet të lihet i lirë menjëherë dhe jo të presë deri sa të mbushen 10 orë.

Sjellim në vëmendje se kjo çështje është sqaruar saktë dhe në mënyrë shteruese edhe në Procedurën standarde të punës “**Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë**”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në Kapitullin V “Përgjegjësitë e punonjësit të policisë në rastet e shoqërimit dhe zbatimi i afateve” parashikohet se:

“1. Punonjësi i policisë ka të drejte të aplikojë masën e shoqërimit dhe mbajë në mjediset e policisë një person për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin apo sqarimin e rrethanave në ngarkim të tij, por jo më shumë se 10 orë.

2. Afati 10 orësh është kufiri maksimal kohor i mbajtjes së një personi.

Në rast se verifikimet e nevojshme (identifikimi dhe sqarimi i rrethanave) përfundojnë në një kohë më të shkurtër se sa është afati maksimal, oficerit të policisë i paraqiten dy mundësi:

- a. *Të lirojë menjëherë të shoqëruarin;*
- b. *Të kryejë ndalimin/arrestimin e tij, në bazë të nenit 253/2 dhe nenit 251/3 të Kodit të Procedurës Penale;*

3. *Kur qëllimi i masës së shoqërimit është realizuar brenda një afati kohor më të shkurtër dhe punonjësi i policisë që ka kryer procedurat e verifikimit vazhdon ta mbajë personin, me arsyetimin se nuk është plotësuar afati 10 orë, do konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe mund të ndiqet penalisht në bazë të nenit 250 të K. Penal (Kryerja e veprimeve arbitrare)*”.

3. Ankuesi na bën me dije se ka bërë kallëzim ndaj shtetasit K.M., por nga përgjigjja e dërguar nga ana juaj nuk rezulton që atij t’i jetë marrë kallëzim, por vetëm shpjegime (deklarime) lidhur me konfliktin e ndodhur. Ne vlerësojmë se në këtë rast pavarësisht rrethanave në të cilat ka ndodhur konflikti ndërmjet studentit dhe pedagogut, punonjësit e policisë gjyqësore që kanë kryer veprimet lidhur me këtë ngjarje duhet t’i kishin marrë

kallëzim ose ankim edhe shtetasit M.K. në bazë të nenit 283³ ose nenit 284⁴ të Kodit të Procedurës Penale dhe jo vetëm shtetasit K.M.. Në këtë rast oficeri i policisë gjyqësore duhet të zbatonte detyrimin ligjor që të paralajmëronte z. M.K. për pasojat që do të kishte në rast se do të bënte kallëzim të rremë në bazë të nenit 305⁵ të Kodit Penal. I takonte organit të akuzës që të bënte vlerësimin e kallëzimit/ankimit të tij nëse ishte i bazuar ose jo.

4. Procesverbali i veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar është përpiluar nga oficeri i policisë gjyqësore Florian Çeka. Ky fakt rrëzon pretendimin e ankuesit se nuk është mbajtur ky dokument. Ndërsa pretendimin e tij se nuk i është dhënë kopje e këtij dokumenti, jemi në pamundësi që ta provojmë.

Gjithësesi, nga këqyrja e këtij procesverbali konstatojmë disa mangësi dhe pasaktësi dhe më konkretisht:

- Në krye të këtij procesverbali, në paragrafin e parë, është shënuar data e përpilimit të tij, më 02.08.2022, por në fakt data e shoqërimit të shtetasit M.K. është 08.09.2022, dhe se në këtë datë duhet të jetë mbajtur edhe ky procesverbal, pra nuk përputhen as data dhe as muaji i mbajtjes së tij;
- Ora dhe data e shoqërimit nuk është plotësuar;
- Veprimet e kryera nga punonjësi i policisë nuk janë pasqyruar;

³ Neni 283 Kallëzimi nga ana e shtetasve

1. Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.
2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.
3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

⁴ Neni 284 Ankimi

1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 84, 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 148, 149, 243, 254, 264, 275, 290 paragrafi i parë dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e viktimës, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.
2. Ankimi bëhet nga viktima te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e një deklaratë, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale.
3. Kur ankimi bëhet me gojë procesverbali që mbahet për këtë qëllim nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij.
4. Ai që merr ankimin sigurohet për identitetin e ankuesit dhe i dërgon aktet prokurorit.
5. Për rastet e parashikuara nga neni 59, ankimi bëhet në gjykatë nga viktima akuzuese.

⁵ Neni 305 “Kallëzimi i rremë” parashikon se:

“Kallëzimi për kryerjen e një krimi që dihet se nuk është kryer ose për kryerjen e një krimi nga një person që dihet se nuk e ka kryer atë, si edhe, krijimi i provave të rreme me qëllim që të bëhen ndjekje penale, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”.

- Data e lënies së lirë të ankuesit nuk është pasqyruar, por është shënuar ora, muaji 09, dhe viti 2022.

Procesverbali është nënshkruar nga i shoqëruari, i cili ka shkruar me shkrim dore se nuk ka pretendime.

Ne çmojmë se këto konstatime provojnë se procesverbali nuk është përpliluar me përgjegjësi e përgjegjshmëri nga oficeri i policisë gjyqësore Florin Çeka dhe konform detyrimit ligjor të parashikuar në Kreun VII të Procedurës Standarde të punës të cituar më sipër⁶.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi nga ana juaj për të garantuar përmbushjen e detyrimeve ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të shoqëruar në ambientet e komisariateve të policisë dhe marrjen e administrimitin e kallëzimeve/ankesave në përputhje me aktet normative në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË :

⁶ VII. “PROCEDURA TË DOKUMENTIMIT TË VEPRIMIT TË SHOQËRIMIT”

a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:

a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

a.3.2 - Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

a.3.3 - Procesverbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.

a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.

1. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e këtij rasti dhe nxjerrjen e përgjegjëseve konkrete ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkeljet ligjore të parashtruara më sipër.

2. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat në varësi të saj me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi